



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, versioni i redaktuar i "Raportit të Katërmbëdhjetë mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces", i cili fillimisht u dorëzua si konfidencial, u bë publik më 23 gusht dhe mund të gjendet në faqen e internetit të DHSK-së. Në këtë raport, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave i përcolli Trupit Gjykses kërkesat e nëntë viktimave, me rekomandimin që ato të pranohen të marrin pjesë në proces si pjesë e grupit të viktimave pjesëmarrëse.

Në të njëjtën çështje, më 23 gusht, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë një apel të Mbrojtjes ku kundërshtohej vendimi i Trupit Gjykses për t'i lejuar ZPS-së të paraqiste për pranim prova të cilat nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me ndonjë prej dëshmitarëve.

Seancat në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* do të rifillojnë të hënën e ardhshme, 28 gusht, në orën 9:00.

Në gjykimin e *Pjetër Shalës*, Mbrojtësi i Viktimave paraqiti provat e tij në fillim të javës, ndërsa sot dhe nesër zhvillohet konferenca për përgatitjen e Mbrojtjes. Trupi Gjykses njoftoi se ndër temat që do të diskutohen në seancë janë ecuria e hetimeve të Mbrojtjes; rendi në të cilin Mbrojtja do t'i thërrasë dëshmitarët; nëse Mbrojtja do të kërkojë masa mbrojtëse për dëshmitarët; nëse Mbrojtja ka ndër mend të kërkojë që dëshmitari 04 të dëshmojë përmes videolidhjes dhe nëse ka ndër mend të kërkojë të njëjtën masë edhe për dëshmitarë të tjerë; nëse ndonjë prej dëshmitarëve do të duhet të pyetet jashtë sallës së gjyqit; nëse për ndonjë prej dëshmitarëve do të duhet të jepen garanci për mosinkrimimin e vetvetes dhe nëse Mbrojtja do të ketë nevojë që disa prej seancave të kryhen në seancë private.

Në të njëjtën çështje, javën e kaluar Trupi Gjykses pranoi një numër provash, duke miratuar një numër kërkesash të Prokurorisë, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave.

Javën e kaluar, një vendim i mëhershëm në lidhje me pranimin e provave në këtë çështje gjyqësore, u bë gjithashtu publik. Në veçanti, në vendimin e 4 korrikut 2023, Trupi Gjykses pranoi si prova deklaratat me shkrim të pesë dëshmitarëve që nuk është e mundur të dëshmojnë në gjykatë, katër prej të cilëve për shkak se kanë ndërruar jetë. Trupi Gjykses e bazoi vendimin në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe në vendimin që mori për secilën deklaratë me shkrim që, ndër faktorë të tjerë, deklarata ishte e besueshme, që nuk cenonte dhe nuk binte ndesh me të drejtat e të akuzuarit, dhe se ishte relevante dhe autentike.

Në çështjen gjyqësore të *Salih Mustafës*, Paneli i Apelit ka caktuar mbajtjen e një seance të apelit të enjten, në 26 tetor 2023, duke filluar nga ora 13:30, dhe të premten, 27 tetor 2023, në orën 9:30. Sipas rendit të ditës, në seancë do të përfshihen deklaratat të Kryegjykatëses dhe argumente me gojë nga Mbrojtja, Prokuroria dhe Mbrojtësja e Viktimave.





Më 18 gusht, Zyra e Prokurorit të Specializuar njoftoi Gjykatësin e Vetëm të DHSK-së se Prokuroria ka pushuar hetimet ndaj z. Driton Lajçi. Kronologjinë e zhvillimeve të mëhershme në atë çështje mund ta gjeni në rubrikën “Aktuale” në faqen e internetit të DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

